

ELIMINIMI I ELITËS FETARE TË SHQIPTARËVE SI FORMË E GJENOCIDIT SERB (1878-1999)

Nuridin AHMETI
Instituti Albanologjik
Prishtinë

Punim studimor

Përmbajtje e shkurtër: Pjesë e rëndësishme e shoqërisë shqiptare gjatë historisë janë edhe krerët fetarë. Të lidhur me vendin dhe popullin ku shërbenin, sa herë popullit i është ekspozuar gjenocidit nuk janë kursyer as ata. Duke qenë se kjo shtresë kishte rol të veçantë shpirtëror, por edhe intelektual, ndikimi i saj në shoqërinë shqiptare ishte i theksuar. Kështu, shumë herë elita fetare shqiptare u vu në ballë të ngjarjeve me karakter shoqëror e politik në vendin tonë, ndërsa kjo rrjedhimisht bëri që ata të jenë ndër të parët që do t'i ekspozoheshin gjenocidit.

Nga vitit 1878, kur Serbia fitoi pavarësinë dhe një pjesë e territoreve shqiptare u gllabëruan padrejtësisht, ndërsa popullata e tyre u largua me dhunë nga ato troje. Largimet e popullatës shumë herë ishin të shoqëruara edhe me masakrime, duke mos kursyer as moshë e as gjini. Sidomos u atakuan krerët fetarë. Luftërat ballkanike dhe periudha ndërmjet dy luftërave botërore njihen për planet e pushtetit të atëhershëm serb për eliminim e elitës fetare të shqiptarëve, sepse ky veprim makabër ndaj tyre ia lehtësonte veprimin pushtuesit në ato vende. Haxhi Zeka, At Luigj Palaj, Mulla Ademi i Keçekollës, Mulla Agan Koja, At Shtjefën Gjeçovi, Mulla Idriz Gjilani, At Bernard Llupi etj., janë vetëm disa emra të njohur nga kjo elitë që u eliminuan nga forcat serbe. Por, planet për eliminim e kësaj elite nga pushteti serb nuk pushuan as pas Luftës së Dytë Botërore e deri në luftën e fundit

në Kosovë, ku në listën e të vrarëve dhe të dëshmorëve figurojnë edhe emra të krerëve tanë fetarë.

Për sa u tha më sipër, në këtë vështrim do të prezantojmë eliminimin e planifikuar të figurave tona fetare nga pushtetit serbë, duke u fokusuar nga viti 1878 e deri në luftën e fundit në Kosovë.

Fjalët çelës: krerë fetarë, mysliman, katolik, prift, hoxhë, shejh, gjenocid, kishë, xhami, teqe etj.

Hyrje

Njëra nga format e njohura të gjenocidit serb ndaj shqiptarëve është edhe eliminimi i figurave kundërshtarë të njohura dhe me ndikim në vendin ku ato vepronin. Format e tilla të veprimit të gjenocidit serb ndaj popullit shqiptar, e rrjedhimisht edhe ndaj krerëve fetarë, vihen në përdorim nga gjysma e dytë e shek. XIX e ndoshta edhe më herët. Nga vitet 70 të shek. XIX, posaçërisht gjatë viteve 1876-77, nga ajo që njihet si lufta serbo-turke dhe më pas, ka një intensifikim për spastrime etnike të trojeve shqiptare, sidomos me largimin e shqiptarëve me dhunë nga Sanxhaku i Nishit. Organizimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe organizimeve të tjera me karakter politiko-shoqëror nga shqiptarët që do të pasojnë më vonë, sigurisht se do të jenë pengesë për planet ekspansioniste të Serbisë, e kjo nënkupton se Serbia do të vihet në lëvizje për t'i penguar këto organizime dhe veprimtaritë e tyre. Kur format e përçarjes në këto organizime, por edhe format e tjera për t'i penguar këto nisma nuk jepnin rezultate, nuk përjashtohej edhe eliminimi i krerëve të njohur të lëvizjeve kombëtare shqiptare. Disa nga krerët tanë fetarë, duke qenë pjesë e elitës sonë kombëtare, u vunë në shënjestër të pushtetit serbë, të cilët më pas edhe u eliminuan në forma të ndryshme. Nga gjysma e dytë e shek. XIX e deri në luftën e fundit në Kosovës kjo formë e gjenocidit ka vazhduar ndaj krerëve fetarë të shqiptarëve.

Feja dhe krerët fetarë në programet serbe për eliminimin e shqiptarëve

Se aspektet fetare të shqiptarëve dhe krerët e tyre ishim pengës për pushtetin serbë, flet edhe fakti se edhe në programet shfarosëse serbe, të përpiluara nga intelektual dhe institucionet serbe, vihet në fokus mënyrat

e presioni ndaj prijësve fetarë me qëllim të shpërnguljes së shqiptarëve nga trojet e tyre.

Perandoria Austro-Hungareze, siç dihet, në marrëveshje me Perandorinë Osmane kishte kujdesin për popullatën katolike që jetonte brenda Perandorisë Osmane, e rrjedhimisht edhe për popullatën katolike në hapësirat shqiptare.¹ Një përkujdesje si kjo nga Perandoria Austro-Hungareze për popullatën katolike, për përpiluesit e programeve serbe përbente probleme në realizimin e planeve të tyre. Në lidhje më këtë, përpiluesit e programeve, nuk mbetën pa e vënë në dukje këtë aspekt. Përpiluesit e programeve i porositnin zbatuesit që popullsinë katolike me një kujdes të veçantë duhet sa më para ta largojnë nga ndikimi i Austrisë e më vonë edhe i Austro-Hungarisë.

Decidivisht te programi i njohur “Naçertanije”, i Ilija Grashaninit i vitit 1844, potencohet “Që populli i fesë katolike të largohet nga Austria dhe që ndikimi i saj të kthehet nga Serbia është punë që ka nevojë për kujdes të veçantë. Kjo do të mund të arrihet me ndërmjetësimin e priftërinjve katolik, të cilët duhet të binden për idenë e bashkimit të Serbisë dhe Bosnjës”.² Sigurisht, se këtu hyjnë edhe krerët fetarë katolikë të shqiptarëve.

Ndërsa, në elaboratin e Vasa Çubrilloviqit të vitit 1937, për spastrimin e shqiptarëve nga trojet e tyre etnike, thuhej se shqiptarët duhet të preken edhe në aspektin fetar, sepse, sipas përpiluesit të këtij elaborati, “shqiptarët janë shumë të ndjeshëm (në çështjen fetare, N. A.), prandaj edhe këtu duhet të preken. Kjo mund të arrihet me keqtrajtimin e klerikëve, me prishjen e varrezave...”.³ Gjatë kësaj periudhe janë të njohura raste kur është bërë presion mbi krerët tanë fetarë në forma të ndryshme. Sa për ilustrim e përmendim edhe rastin e imamit të një fshati afër Prishtinës, i njohur si Hoxhë Breznica, të cilit në periudhën në mes dy luftërave botërore, pa e marrë pëlqimin e tij, në tokën e tij vendosin kolonë serbo-malazezë, ku më pas fillon përleshja mes hoxhës në fjalë dhe kolonëve, të cilët ishin vendosur në truallin e tij, dhe si rezultat mbesin të vrarë disa kolonë serbo-malazezë dhe familjarë të hoxhës. E

¹ Fehari Ramadani, *Kontributi i Austro-Hungarisë për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare 1900-1912*, Tetovë, 2010, f. 16-18.

² *Politika serbomadhe prej Grashaninit deri te Akademia*, (Përktheu dhe përgatiti: Flaka Surroi), Koha, Prishtinë, 2019, f. 28-29.

³ “Shpërngulja e Arnautëve”, *E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë – Instituti i Historisë, Tiranë, 1990, f. 323.

shënova si rast, sepse nuk është shkruar mjaftueshëm për këtë ngjarje, ndërsa folklori ynë kësaj ngjarjeje i ka kushtuar kujdes.⁴ Prishja e varrezave si formë e presionit për largimin e popullatës nga trojet e tyre, ishte e njohur te shqiptarët edhe para përpilimit të elaboratit të Vasa Çubrilloviçit të vitit 1937. Kështu, më 1935, Ferhat Draga në një shkresë zyrtare dërguar organeve qeveritare të atëhershme ve në dukje edhe këtë fenomen ku shkruan se “në Novi-Pazar u mat dhe duhet te ndahet toka e Vakufit haxhet, ku ndodhen e regullume bukur varrezat muhamedane. Populli pyet” po a thue as te vdekurit nuk lehen te qete?” kësaj çudie prej reformes agrare i shtojm ç’fare reforme asht kejo kurse dhe varrezat i damton?”⁵

Në vitin 1941, Stevan Moleviq përpiloi programin e tij “Serbia homogjene”, në të cilin program kur është fjala për aspektin fetar e potencon se duhet t’iu jepet liria fetare popujve në Jugosllavinë e atëhershme. Menjëherë në disa rreshta më poshtë, në po të njëjtin program thuhet se “nuk mund të formohet parti politike në baza fetare”.⁶ Se pse nuk mund të formohet parti fetare, sipas Stevan Moleviqit, kjo mund të kuptohet më së mirë nga elaborati i dytë i Vasa Çubrilloviqit i hartuar më 1944 me titullin “Problemi i pakicave kombëtare në Jugosllavinë e Re”. Në këtë elaborat, në lidhje me shqiptarët, autori tërheq vërejtjen “Shqiptarët në Serbinë e Vjetër dhe në Maqedoni, nëpërmjet Autonomisë së Bashkësisë Fetare Islame, kanë arritur ta marrin në duart e veta organizatën, e cila do t’u shërbente në mënyrë të gjithanshme qëllimeve të tyre kulturore dhe nacionale politike”.⁷ Kur e lexon citatin lartcekur, e sheh se veprimtaria e partisë “Shoqata Islamike për Mbrojtjen e Drejtësisë”, e njohur si “Xhemijeti”, e themeluar në Shkup më 1919 dhe e cila vazhdoi me veprimtarinë e saj deri më 1925, e udhëhequr nga Nexhip Draga⁸, ishte pengesë për intelektualët serbë. Kjo organizatë politike e mbështjellë edhe me petkun fetar, sepse legjislacioni i kohës

⁴ “Hoxhë Breznica la amanet: -Për me vra ata qi t’vret! Të mrohet erzi e njerëzija, gjithë shyptart e Shypnija”; *Këngë popullore historike III*, IA, Prishtinë, 2007, f. 256-278.

⁵ Nuridin Ahmeti, “Dëmtimi sistematik i pronave private dhe vakëfeve në Shkup sipas një shkrese zyrtare të Ferhat Dragës të vitit 1935”, *Scupi*, nr. 12, ITSHKSH, Shkup, 2015, f. 244.

⁶ Hivzi Islami, *Spastrimet etnike politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve*, Dukagjini, Pejë, 2003, f. 278.

⁷ *Po aty*, f. 282.

⁸ Skender Asani, *Veprimtaria e organizatës politike Xhemijeti në trevat lindore (1919-1925)*, Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2017.

nuk lejonte të formoheshin parti në baza etnike, e shtriu ndikimin edhe të Bashkësia Fetare Islame e asaj kohe në Shkup dhe kjo bashkësi së bashku me Xhemijetin dhe organin i saj “Hak”, kishin bashkërenduar punët në mbrojtjen e interesave të shqiptarëve dhe ky fenomen nuk u ka ikur përpiluesve të programeve serbe.

Përpiluesit e elaboratit i fikësoheshin (ri)ngritjes eventuale së një organizate, siç ishte “Xhemijeti”, prandaj ata e vinin në dukje se një veprim të tillë duhet sanksionuar sa më parë. Siç edhe dihet nga të dhënat historike, gjatë periudhës së veprimit të “Xhemijetit” janë të njohura dhjetëra reagime të udhëheqëseve të kësaj partie dhe deputetëve të kësaj partie që ishin në Parlamentin e Jugosllavisë së asaj periudhe, kundër shkeljes së të drejtave të shqiptarëve që po i bënte pushteti serb asokohe.⁹

Pra, për realizimin e qëllime të tyre pushteti serb e shihte si të domosdoshëm bashkëpunimin me klerikët dhe, në qoftë se ata do të rezistonin, kuptohet se ata do të përdornin edhe format e ndryshme të kërcënimit deri tek eliminimi.

Eliminimi i krerëve fetarë të shqiptarëve

Edhe nga programet serbe mund të vërehet se fokusi i pushtetit serb ishte tek ata prijës fetarë që kishin ndikim në masën ku vepronin, apo edhe tek ata klerikë që kishin pozita në lëvizjet e ndryshme me karakter shoqëror e politik të shqiptarët. Sigurisht, se ata krerë fetarë që ishin zgjedhur në poste kyçe në lëvizjet kombëtare të shqiptarëve, ishin njerëz me formim dhe taban të fortë shpirtëror e kombëtar, ndaj si të tillë ia pamundësonin pushtetit serb manipulimin me ato figura fetare në shkallën që ata dëshironin. Kur metodat e përfutimit, shantazhit, nuk kishin suksese, pushteti përdorte edhe formën e eliminimit. Disa nga personalitetet që vinin nga radhët e krerëve tanë fetarë dhe të cilët e përfunduan jetën e tyre me eliminime në forma të ndryshme, janë edhe emrat të cilët do t'i potencojmë më poshtë, edhe pse nga të dhënat e gjertanishme na rezulton se numri i tyre është edhe më i madh se sa këta që i trajtuam.

Myderriz Ymer ef. Prizreni, personalitet i shquar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e cila u formua më 1878. Nga të dhënat e gjertanishme

⁹ Skender Asani, *Dokumente për veprimtarinë politike të Xhemijetit*, Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2017.

thuhet se lindi më 1820 në Prizren. U shkollua në vendlindje dhe në Stamboll në fushën e dijes fetare islame. Ishte aktiv në jetën publike në Prizren, si ligjërues në medrese dhe myfti. Si deputet në Parlamentin Osman në vitet 1877-1878, u shqua si njëri nga deputetët në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve. Ishte ndër organizatorët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe më vonë do t'i besohet edhe posti, në janar të vitit 1881, i udhëheqësit të qeverisë së përkohshme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në prillin e vitit 1881, kur forcat osmane shuan Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, Ymer Prizreni largohet për në Ulqin. Ndërroi jetë në Ulqin më 1887¹⁰, ku edhe sot gjendet varri i tij. Sipas të dhënave, Ymer Prizreni ishte goditur me mjet të fortë dhe për pasojë ndërron jetë, edhe pse për porositesit e këtij akti në mesin e historianëve ka disa mendime, se ishte Porta e Lartë¹¹, makineria antishqiptare sllave¹², pushteti i Malit të Zi me Serbinë¹³ etj.

Haxhi Mulla Zeka, njëri ndër personalitet e shquara të Lëvizjes Kombëtare, i lindur në rrethinën e Tropojës në fshatin Shoshan, më 1832. Kreu mësimin në Medresenë e Madhe të Gjakovës.¹⁴ U dallua si njëri ndër organizatorët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Mori pjesë në luftimet kundër Mehmet Ali Pashës që u zhvilluan në Gjakovë. Nga viti 1893 organizoi kryengritje kundër forcave osmane. Në histori, si emër shquhet për organizimin e Lidhjes Shqiptare të Pejës, më 1899, ku edhe u zgjodh kryetari i saj. U vra më 1902. Të dhënat historike në lidhje me vrasjen e tij tregojnë se në këtë ngjarje ishte i implikuar edhe konsulli serb në Prishtinë Sima Avramović dhe se ky eliminim u realizua përmes Adem Zajmit, në Pejë, më 1902.¹⁵

¹⁰ Ali Bardhi, *Varrezat në Ulqin*, Art Club, Ulqin, 2019, f. 68.

¹¹ Marenglen Verli, “Disa sondazhe në dokumentacionin konsullor austrohungarez për Ymer Prizrenin”, *Ymer Prizreni –personalitet i shquar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare* (Sesion shkencor 25-6 maj 2022), Art Club, Ulqin, 2002, f. 67.

¹² Muhamet Pirraku, “Arratisja nga Kosova, jeta dhe përfundimi tragjik i Ymer Prizrenit në Ulqin”, *Ymer Prizreni –personalitet i shquar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare* (Sesion shkencor 25-6 maj 2022), Art Club, Ulqin, 2002, f. 144.

¹³ Muhamet Pirraku, *Myderriz Ymer Prizreni ora, zemra dhe shpirti i Lidhjes Shqiptare 1877-1887*, Sharr, 2003, f. 440.

¹⁴ Shevqet Canhasi, *Haxhi Zekë Byberi 1832-1902*, Prishtinë, 2004, f. 70.

¹⁵ Zekeria Cana, “Planet e Serbisë për ndezjen e luftës vëllavrasëse ndërmjet shqiptarëve dhe për zhdukjen e udhëheqësve të tyre”, *Gjenocidi dhe aktet gjenocidale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga kriza lindore e këndeje*, (Simpozium i mbajtur në Prishtinë më 20-21 janar 1994), ASHAK, Prishtinë, 1995, f. 62.

At *Luigj Palaj*, lindi në Janjevë, më 1878. Vinte nga radhët e françeskanëve të klerit katolik. Ka shërbyer si famullitar në Shkodër, Gjakovë e Pejë. Në vitin 1913, kur forcat serbo-malazeze po i konvertonin dhunshëm shqiptarët në fenë ortodokse, Luigj Palaj nuk pajtohej që pjesëtarët e komunitetit të tij të konvertoheshin në ortodoksë¹⁶ dhe ky qëndrim do t'i kushtonte me arrestim, më pastaj burgosje dhe nga torturat e shumta ndërron jetë më 1913 në Janosh të Gjakovës. Austro-Hungaria, përmes përfaqësive konsullore në hapësirat shqiptare, reagoi për vrasjen e tij. Jehonë vrasjes së tij i bënë edhe gazetatat që dilnin në Vjenë.¹⁷ Gjithashtu, në lidhje me këtë ngjarje, Gjergj Fishta shkroi në revistën "Hylli i dritës".¹⁸ Ndërsa, në telegramin e dërguar nga Drejtoria Krahinore e Pejës më 1913, për Ministrinë e Brendshme në Cetinë, në lidhje me vrasjen në fjalë thuhej se "u vra me katër plumba dhe prapa shpine".¹⁹

Mulla Adem ef. Emërllahu, lindi më 1850 në afërsi të Prishtinës, në fshatin Prapashticë. Shkollimin e kreu në Prishtinë, Shkup e Stamboll. Gjatë jetës së tij ka shërbyer si imam në fshatin e tij të lindjes dhe në Keqekollë afër Prishtinës. Gjatë viteve 1908 bashkëpunoi me veprimtarë të lëvizjes kombëtare që vepronin zonat e Llapit dhe Gollakut dhe kjo do t'i kushtonte me burgosje e me dënim me vdekje. Pas një kohe relativisht të shkurtër do të lirohet me dekret të sulltanit. Më 1911 ishte njëri ndër ata që mori pjesë në pritjen e Sulltan Mehmet Reshatit në Vilajetin e Kosovës. Pas largimit të Perandorisë Osmane nga këto troje, Mulla Ademi vazhdoi bashkëpunimin me forcat kaçake shqiptare të kësaj ane dhe më 10 janar të vitit 1921 forcat serbe e masakruan Mulla Ademin²⁰ së bashku me nëntë anëtarë të familjes, në mesin e të cilëve edhe një foshnjë në djep.²¹ Varri i Mulla Ademit sot

¹⁶ Viktor Sopi, "Veprimtaria diplomatike e Lazër Mjedës, karshi trysnive fetare dhe politike ndaj shqiptarëve", *Scupi*, nr. 12, ITSHKSH, Shkup, 2015, f. 129.

¹⁷ Albert Ramaj, "Gjendja e Argjipeshkvisë së Shkupit dhe veprimtaria e argjipeshkvit Lazër Mjeda", *Scupi*, nr. 12, ITSHKSH, Shkup, 2015, f. 167-169.

¹⁸ Gjergj Fishta, "Kanibalizimi slav a se deka e shemtume e P. Luigjit Paliq", *Hylli i dritës*, nr. 3, dhetuer 1913, f. 79-85.

¹⁹ Zekeria Cana, *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912-1913*, IA, Prishtinë, 1996, f. 144.

²⁰ Qerim Lita, "Burimet shqiptare mbi masakrën e vitit 1921 në Keqekollë dhe Prapashticë", *Shenja*, nr. 133, Shkup, 2022, f. 95.

²¹ Ramadan N. Ibrahim, *Masakra në Prapashticë dhe Keqekollë, (janar 1921)*, botimi i dytë, Prishtinë, 2010, f. 95.

gjendet ne lagjen Hoxhaj të Keqekollës, pranë shtëpisë së tij ku ka jetuar dhe ku është masakruar.²²

At Shtjefën Gjeçovi, në listën e të krerëve fetarë të vvarë nga pushtit serb, bën pjesë edhe françeskani At Shjefën Gjeçovi. Lindi në Janjevë më 1874. Shkollimi e kreu në vendlindje, Bosnjë dhe Kroaci. Ka shërbyer si meshtar në disa vende në trojet shqiptare. Vlerësohet për kontributin e tij në shkencën e arkeologjisë shqiptare, (ri)hapjen e shkollave shqipe, publicistikë, e në veçanti në mbledhjen, kodifikimin dhe më pas botimin e veprës “Kanuni i Lekë Dukagjinit”. Përkushtim i tij në ndriçimin e kulturës kombëtare, sigurisht se nuk do të shihet me sy të mirë nga organet e atëhershme dhe më 14 tetor 1929 vritet nga forcat serbe në Kosovë në afërsi të fshatit Zym të Hasit.²³

Mulla Agan Koja. Njëri ndër veprimtarët e njohur, i cili iu përkushtua çështjes së çlirimit dhe bashkimit të tokave shqiptare, ishte dhe Abdylgani Koja - alias Mulla Agan Koja, i lindur në Kajë të Plavës të Malit të Zi më 1892, ku edhe merr mbiemrin Kaja sipas vendlindjes, kurse, nga të dhënat e gjertanishme, na rezulton se emri “Agan” është akronim i fjalës Abdylgani, siç edhe figuron të jetë i nënshkruar në librat e tij. Në historinë e re shqiptare është i njohur si Mulla Agan Koja²⁴ apo Kaja²⁵ dhe si Mulla Agan Plava, mbiemër ky sipas rajonit nga vinte. Nga të dhënat për shkollimin e tij, thuhet se mësimet i mori në mejtepin e Plavës, në Medresenë e Gjakovës dhe në Shkup.²⁶ Shërbeu si imam në Plavë.²⁷ Ishte, ndër udhëheqësit e Komitetit Mbrojtja Kombëtare e

²² Ali Sh. Berisha- Arben Berisha, *Gallapi i Prishtinës III (1912- 1941)*, Prishtinë, 2009, f. 186.

²³ Markus W. E. Peters, *Përballjet e historisë së kishë katolike në Shqipëri 1919-1996*, (Përktheu nga gjermanishtja: Klaudia Darragjati), Qendra Botuese Shoqata Jezuite, Tiranë, 2010, f. 289-290.

²⁴ Muhamet Shatri, “Të dhëna biografike mbi disa veprimtarë të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës* (Përmbledhje kumtesash), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë – Tiranë, Instituti i Historisë – Prishtinë, f. 2004, f. 165.

²⁵ *Fjalor Enciklopedik Shqiptar 2*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 1090.

²⁶ Arkivi i Institutit të Historisë – Tiranë (*më tej*: AIHT), Fondi (*më tej*: F), A – VII – 356, fl. 5.

²⁷ Elmaz B. Plavës, *Plava dhe Gucia në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare* (Kujtime dhe dokumente historike), ShB, Marin Barleti, Tiranë, 2002, f. 238.

Kosovës për rajonet e Plavës dhe Gucisë.²⁸ Më 1930 vritet në Tropojë nga agjencurat serbe.²⁹

Në gazetën “Rilindja e Arbërit”, nr. 69, të datës 18 shtator të vitit 1930, ku u botua një artikull rreth vrasjes së këtij veprimtari, shkruhet: “Mulla Agani me të shoqen dhe rrogëtarin duke e falë “jacinë”, kriminelët duke përfitur nga kjo gjendje, të 4 vetat, i drejtojnë pushkët dhe zbrazin dy batara”.³⁰

At *Bernard Llupi* ishte ndër veprimtarët e njohur të Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare në Kosovë. Lindi në Shkodër më 1886. Shkollimin për teologji krishtere e kreu në Shkodër, Grac dhe Insbruck³¹ të Austrisë. Më 1941 kishte pozita menaxhuese në Shkodër si drejtor i Urdhnit të Motrave Katolike “Bijat e Zojës së Bekueme”. Detyrën e meshtarit e filloi në Pejë, më 1942, duke qenë përgjegjës edhe për disa famulli të tjera në Kosovë si Zllakuqan, Zym, Has dhe kishat katolike në Gjakovë. Ishte njohës i disa gjuhëve të huaja. Për shkak të veprimtarisë së tij në NDSH dhe lidhjeve me disa nga pjesëtarët e kësaj organizate, burgoset dhe dënohet në Prizren.³² Pushkatohet më 1946.

Mulla Idriz Gjilani lindi më 1901 në Velekincë të Gjilanit. Shkollimin e kreu në Cernicë dhe Gjilan. Kreu detyrën e imamit në fshatra të Gjilanit e Kamenicës. Shquhet edhe në veprimtarinë shkrimore. Në historinë e re shqiptare është i njohur si udhëheqës i forcave vullnetare shqiptare, kundër forcave partizane në Kosovën Lindore.³³ Nga vitit 1944 kur forcat partizane-çetnike e pushtuan Gjilanin më 1944, vepron në ilegalitet, deri sa arrestohet më 1949. Studiuesi Muhamet Pirraku, i pari autor shqiptar që shkroi monografi për këtë personalitet, fundin e jetës së Mulla Idrizit, e përshkruan në këtë formë: forcat partizane-çetnike “ia morën shpirtin me zjarr e tortura mizore tjera, në orët e para të datës 26 nëntor 1949, ose aty pas mesnatës së 25-26 nëntorit, e premtë

²⁸ Marenglen Verli, “Roli i Komitetit “MKK”, në organizimin e qëndresës kundër ripushtimit serb në Plavë dhe Guci (tetor 1918 – shkurt 1919)”, *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*, (Përmbledhje kumtesash), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë – Tiranë, Instituti i Historisë – Prishtinë, 2004, f. 77 – 88.

²⁹ Nuridin Ahmeti, “Të dhëna mbi veprimtarinë atdhetare të Mulla Abdylgani Kojës”, *Myderriz Hfz. Bajram ef. Agani jeta dhe vepra (1899-1962)*, Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor (Prishtinë, 7 dhjetor 2013), KBIK, Prishtinë, 2015, f. 19-25.

³⁰ Elmaz B. Plavës, *Vep. e cit.*, f. 246.

³¹ Në këtë qytet e ka përfunduar Fakultetin e Farmaceutikës.

³² Ethem Çeku, *Shekulli i ilegales*, Brezi '81, Prishtinë, 2004, f. 160-162.

³³ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Vëll. IV, Akademia e Studimeve Albanologjike – Institutit i Historisë, Tiranë, 2021, f. 502.

në të shtunë.³⁴ Duhet potencuar, se kujtesa jonë popullore dhe folklori ynë, i ka kushtuar kujdes këtij personaliteti, duke i përcjellë të dhënat brez pas brezi. Të bëmat dhe ligjërimi i Mulla Idrizit, kanë mbetur si referencë në traditën tonë popullore edhe në ditët e sotme.

Mustafë Veseli lindi më 1966 në Reçan të Suharekës. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen, Medresenë “Alaudin”, në Prishtinë. Ka shërbyer si imam në muajt e caktuar. Vritet në demonstratat e muajit mars të 1989 në Prishtinë.³⁵

Shejh Muhidin Shehu lindi më 1920 në Rahovec në një familje me tradita në tarikatin Halveti. Përfundoi shkollimin fillor dhe medresenë, ndërsa diplomën për epror të teqesë e mori në Prizren në Teqenë e Halvetive.³⁶ Nga vitit 1940 ka drejtuar Teqenë e madhe të Halvetive në Rahovec. Pas Luftës së Dytë Botërore, ishte aktiv në Lëvizjen Nacional Demokratike Shqiptare dhe si pjesëtar i kësaj organizate me nofkën “Jemeni” dënohet nga pushteti jugosllav.³⁷ Ishte kontribuues edhe në lëvizjet shoqërore e politike të vendit tonë. Në korrik të vitit 1998 ekzekutohet në Teqenë e madhe të Halvetive në Rahovec, nga forcat policore dhe paramilitare serbe.

Ramush ef. Shatri lindi në fshatin Tomoc të Istogut. Mësimet i mori në fshatin e lindjes, në Pejë dhe Gjakovë. Shërbyer si imam në disa fshatra të Istogut dhe në vendlindjen e tij. Për shkak të bindjeve dhe veprimeve antikomuniste ishte suspendua nga puna. Ishte aktiv në veprimtaritë e karakterit shoqëror e politikë të asaj anë. Është vrarë nga forcat serbe më 1999.³⁸

³⁴ Muhamet Pirraku, *Mulla Idris Gjilani dhe mbrojtja kombëtare e Kosovës Lindore 1941-1951*, Këshilli i Bashkësisë Islame, Gjilan, 2017, f. 49.

³⁵ Sylejman Osmani, “Dhembja e një nate”, *Dituria islame*, nr. 22, BIK, Prishtinë, 1991, f. 57.

³⁶ Alban Dobruna, *Tarikati islam halveti te shqiptarët*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2017, f. 132.

³⁷ Ethem Çeku, *Vep. e cit.*, f. 112-113.

³⁸ Nexhmedin Hoxha, “H. Mulla Ramush Vesel Shatri 1909-1999”, *Dituria islame*, nr. 113-114, BIK, Prishtinë, 1999, f. 85-86.

Përfundim

Lista e emrave të prijësve tanë fetarë, të eliminuar nga pushteti serb nga viti 1878 e deri në luftën e fundit në Kosovës, është edhe më e gjatë, por ne ua kemi bërë një trajtim vetëm disave prej tyre, të cilët në ngjarje të caktuara me karakter kombëtar e shoqëror kishin të detyra të rëndësishme dhe të dhëna biografike të bollshme.

Për një numër të konsiderueshme të krerëve tanë fetarë dhe për mënyrën e ekzekutimit të tyre, kemi raste kur mungojnë të dhënat e mjaftueshme biografike, por të bëmat e tyre janë regjistruar nga kujtesa e popullit dhe disa prej këtyre figurave janë përjetësuar edhe në këngët tona popullore, sigurisht se në mungesë të dhënave më të bollshme nuk i kemi përfshirë në trajtimin tonë.³⁹

Nga vitit 1878 e deri në Luftën e fundit të Ushtrisë Çlirimtare në Kosovë, mund të thuhet se ka pasur një vazhdimësi të eliminimit të krerëve tanë fetarë. Këtu nuk i kemi përmendur rastet e shumë figurave fetare që janë arrestuar nga forcat serb, sidomos gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe ende sot e kësaj dite nuk u dihet varri. Në luftën e fundit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë të evidentuar edhe disa imamë e nxënës të medresesë, të cilët janë ekzekutuar nga forcat paramilitare serbe, por ne nuk i kemi përfshirë në tërësinë e tyre.

Potencimi i aspekteve fetare dhe krerëve fetarë edhe në planet shoviniste serbe si pengesë për realizimin e planeve të tyre, është edhe

³⁹ Sa për ilustrim, po e përmendim rastin e personalitetit të Mulla Syles apo Sules siç e potencon rapsodi ynë popullor nga fshati Sellcë i Tetovës. Gjithmonë, sipas këngës popullore, në vitin 1915 forcat serbe mbi popullin shqiptar të fshatrave të Tetovës të udhëhequr nga Naçallnik Gjeorgjia, po ushtronin dhunë, ua merrnin tokat etj., dhe një ditë Mulla Sylë me shokë e zëne pritën dhe eliminojnë Naçallnik Gjeorgjin. Në vitin 1918 shtëpia e Mulla Sylës në Sellcë të Tetovës rrethohet nga forcat serbe, dhe në shtëpi nuk e gjejnë. Në mungesë të tij, forcat serbe i burgosin familjarët e tij në burgun e Nishit. Për ta shpëtuar familjen, Mulla Sylë vetë dorëzohet në Nish, dënohet me 12 vjet burgim, dhe pas mbajtjes së dënimit lirohet. Në vitet e '40-ta forcat partizane, po ushtronin dhunë përsëri mbi popullatën e kësaj ane dhe Mulla Sylë e organizon përsëri popullatën kundra forcave partizane, të cilët ishin strehuar në shpellën e Vicës në rrethinën e Tetovës. Forcat e Mulla Syles arrin t'i eliminojnë forcat partizane të cilat ishin strehuar në Shpellën e Vicës. Në vjeshtën e vitit 1944 forcat serbe e rrethojnë shtëpinë e Mulla Sylës, e kapin për së gjalli dhe trupin e tij e pjekin me saç të nxehtë, deri sa ndërrojnë jetë. (<https://www.youtube.com/watch?v=SPTtGTxcQqg>, hulumtuar, më 20 mars 2022).

një tregues për veprimtarinë e drejtë të kësaj shtrese në trojet tona. Sikurse në çdo komunitet etnik, politik etj., edhe në atë fetar nuk përjashtohet mundësia që në raste të caktuara, dikush nga krerët fetarë edhe të mos jenë pajtuar me bindjet e disa veprimtarëve të tanë të kohës, për formën e realizimit të aspiratave kombëtare, por nuk ka të drejtë askush që ta akuzojë një komunitet të terë.

THE ELIMINATION OF THE ALBANIAN RELIGIOUS ELITE AS A FORM OF SERBIAN GENOCIDE (1878-1999)

Summary

Our religious leaders make an important part of the Albanian society throughout history. Connected to the country and the people they served, and whenever the people were exposed to genocide, they were not spared either. Given that this section of the society has had both special spiritual and intellectual role, its influence on the Albanian society was significant. Thus, many times the Albanian religious elite put themselves at the forefront of the events of social and political character in our country, while this consequently made them the first ones to be exposed to genocide.

As of the year 1878 when Serbia gained its independence and had unjustly grabbed a part of the Albanian territories, while forcibly removing their population from those lands. The removing of the population was often accompanied by massacres, sparing no one regardless of their age or gender. Our religious leaders were attacked in particular. The Balkan wars and the period between the two world wars are known for the plans of the then Serbian government to eliminate the religious elite of the Albanians, because this macabre act committed against them made the actions of the invaders easier in those lands. People such as Haxhi Zeka, Father Luigj Palaj, Imam Adem of Keçekolla, Imam Agan Koja, Father Shtjefën Gjeçovi, Imam Idriz Gjilani, Father Bernard Llupi, etc., are just a few of well-known names from this elite who were eliminated by the Serbian forces. However, the plans for the elimination of this elite from the Serbian government had not stopped even after the Second World War including the last war in Kosovo, where on the list

of those killed and martyred appear also the names of our religious leaders.

From the aforesaid, in this overview we will present the planned elimination of our religious figures by the Serbian government with a focus from 1878 until the last war in Kosovo.

LITERATURA:

Arkivi i Institutit të Historisë – Tiranë.

Ahmeti, Nuridin, “Dëmtimi sistematik i pronave private dhe vakëfeve në Shkup sipas një shkrese zyrtare të Ferhat Dragës të vitit 1935”, *Scupi*, nr. 12, ITSHKSH, Shkup, 2015.

Ahmeti, Nuridin, “Të dhëna mbi veprimtarinë atdhetare të Mulla Abdylgani Kojës”, *Myderriz Hfz. Bajram ef. Agani jeta dhe vepra (1899-1962)*, Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor (Prishtinë, 7 dhjetor 2013), KBIK, Prishtinë, 2015.

Asani, Skender, *Dokumente për veprimtarinë politike të Xhemijetit*, Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2017.

Asani, Skender, *Veprimtaria e organizatës politike Xhemijeti në trevat lindore (1919-1925)*, Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2017.

Bardhi, Ali, *Varrezat në Ulqin*, Art Club, Ulqin, 2019.

Berisha, Sh, Ali – Berisha, Arben, *Gallapi i Prishtinës III (1912- 1941)*, Prishtinë, 2009.

Cana, Zekeria, “Planet e Serbisë për ndezjen e luftës vëllavrasëse ndërmjet shqiptarëve dhe për zhdukjen e udhëheqësve të tyre”, *Gjenocidi dhe aktet gjenocidale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga kriza lindore e këndej*, (Simpozium i mbajtur në Prishtinë më 20-21 janar 1994), AShAK, Prishtinë, 1995.

Cana, Zekeria, *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912-1913*, IA, Prishtinë, 1996.

Canhasi, Shevqet, *Haxhi Zekë Byberi 1832-1902*, Prishtinë, 2004.

Çeku, Ethem, *Shekulli i ilegales*, Brezi '81, Prishtinë, 2004.

E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë – Instituti i Historisë, Tiranë, 1990.

Fisha, Gjergj, "Kanibalizimi slav a se deka e shemtume e P. Luigjit Paliq", *Hylli i dritës*, nr. 3, dhetuer 1913.

Fjalor Enciklopedik Shqiptar 2, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008.

Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, Vëll. IV, Akademia e Studimeve Albanologjike – Institutit i Historisë, Tiranë, 2021.

Hoxha, Nexhmedin, "H. Mulla Ramush Vesel Shatri 1909-1999", *Dituria islame*, nr. 113-114, BIK, Prishtinë, 1999.

Ibrahimi, N. Ramadan Ibrahimi, *Masakra në Prapashticë dhe Keqekollë (janar 1921)*, botimi i dytë, Prishtinë, 2010.

Islami, Hivzi, *Spastrimet etnike politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve*, Dukagjini, Pejë, 2003.

Këngë popullore historike III, IA, Prishtinë, 2007.

Lita, Qerim Lita, "Burimet shqiptare mbi masakrën e vitit 1921 në Keqekollë dhe Prapashticë", *Shenja*, nr. 133, Shkup, 2022.

Osmani, Alban, *Tarikati islam halveti te shqiptarët*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2017.

Osmani, Sylejman, "Dhembja e një nate", *Dituria islame*, nr. 22, BIK, Prishtinë, 1991.

Peters, W. E, Markus, *Përballjet e historisë së kishë katolike në Shqipëri 1919-1996*, (Përktheu nga gjermanishtja: Klaudia Darragjati), Qendra Botuese Shoqata Jezuite, Tiranë, 2010.

Pirra, Muhamet, "Arratisja nga Kosova, jeta dhe përfundimi tragjik i Ymer Prizrenit në Ulqin", *Ymer Prizreni –personalitet i shquar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare* (Sesion shkencor 25-6 maj 2022), Art Club, Ulqin, 2002.

Pirra, Muhamet, *Mulla Idris Gjilani dhe mbrojtja kombëtare e Kosovës Lindore 1941-1951*, Këshilli i Bashkësisë Islame, Gjilan, 2017.

Pirra, Muhamet, *Myderriz Ymer Prizreni ora, zemra dhe shpirti i Lidhjes Shqiptare 1877-1887*, Sharr, 2003.

Plava, B. Elmaz, *Plava dhe Gucia në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare* (Kujtime dhe dokumente historike), ShB, Marin Barleti, Tiranë, 2002.

Politika serbomadhe prej Grashaninit deri te Akademia, (Përktheu dhe përgatiti: Flaka Surroi), Koha, Prishtinë, 2019.

Ramadani, Fehari, *Kontributi i Austro-Hungarisë për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare 1900-1912*, Tetovë, 2010.

Ramaj, Albert, “Gjendja e Argjipeshkvisë së Shkupit dhe veprimtaria e argjipeshkvit Lazër Mjeda”, *Scupi*, nr. 12, ITSHKSH, Shkup, 2015.

Sopi, Viktor, “Veprimtaria diplomatike e Lazër Mjedës, karshi trysnive fetare dhe politike ndaj shqiptarëve”, *Scupi*, nr. 12, ITSHKSH, Shkup, 2015.

Shatri, Muhamet, “Të dhëna biografike mbi disa veprimtarë të Komitetit “Mbrotja Kombëtare e Kosovës”, *Komiteti Mbrotja Kombëtare e Kosovës* (Përmbledhje kumtesash), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë – Tiranë, Instituti i Historisë – Prishtinë, f. 2004.

Verli, Marenglen, “Disa sondazhe në dokumentacionin konsullor austro-hungarez për Ymer Prizrenin”, *Ymer Prizreni –personalitet i shquar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare* (Sesion shkencor 25-6 maj 2022), Art Club, Ulqin, 2002.

Verli, Marenglen, “Roli i Komitetit “MKK”, në organizimin e qëndresës kundër ripushtimit serb në Plavë dhe Guci (tetor 1918–shkurt 1919)”, *Komiteti Mbrotja Kombëtare e Kosovës*, (Përmbledhje kumtesash), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë – Tiranë, Instituti i Historisë – Prishtinë, 2004.

